

### AMF pranë studentëve të Universitetit Politeknik të Tiranës

#### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-tetor 2018

#### Zhvillime të tjera

- *Workshop* për prezantimin e projektligjit të ri “Mbi Titujt”
- Trajnim për “Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Fondeve të Investimeve”
- Konferencë “Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Shërbimet Financiare në BE”
- Konferencë mbi sigurimin gjithëpërfshirës
- Seminar mbi “Modelet parashikuese për jetën dhe shëndetin”
- Zhvillohen mbledhjet e Komiteteve të IAIS, Mbledhja e Përgjithshme Vjetore, si edhe Konferenca e 25-të Vjetore
- Takimi i 16-të i Iniciativës së Mbikëqyrjes së Sigurimeve për Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore
- Takim mbi sfidat aktuale të mbikëqyrjes me fokus rrezikun

#### Edukimi i Konsumatorit

- Produkti i Pensionit Personal Pan-Evropian - Një hap drejt pensioneve të qëndrueshme (*pjesa e fundit*)

#### Fjalor Termash

#### Lajme Ndërkombëtare

- Greqi
- Kosovë
- Kroaci
- Mali I Zi
- Slloveni
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## AMF, pranë studentëve të Universitetit Politeknik të Tiranës për rritjen e edukimit financiar



*Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës, Prof. Dr. Andrea Maliqari gjatë nënshkrimit të marrëveshjes*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi në datë 13 nëntor 2018, një leksion të hapur me studentë të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi në datë 13 nëntor 2018, një leksion të hapur me studentë të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike të Universitetit Politeknik të Tiranës. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të “Strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet financiare nën mbikëqyrje”, me qëllim kryesor rritjen e edukimit financiar të studentëve.

Aktivitetit i parapriu nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi mes Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Universitetit Politeknik të Tiranës, nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës, Prof. Dr. Andrea Maliqari. Në fjalën e mbajtur në takim, Z. Koçi theksoi se edukimi financiar është shndërruar në një nga prioritetet e punës së Autoritetit. AMF po vijon fushatat informuese, duke zhvilluar takime në disa universitete të vendit. Në funksionin e saj mbikëqyrës dhe rregullator, AMF ka në thelb të vendimmarrjes së saj mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit.

Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës, Z. Maliqari u deklarua besimplotë se marrëveshja e nënshkruar mes dy institucioneve do të jetë me përfitim reciprok. Ajo do t'i shërbejë studentëve të universitetit, duke i asistuar me materiale të ndryshme burimore, apo duke i krijuar mundësinë e intershipeve pranë Autoritetit. Në anën tjetër, do të jetë një bazë e mirë për thellimin e bashkëpunimit, me qëllim zgjerimin e njohurive financiare të studentëve dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës.

Në orën e hapur të leksionit, studentët u njohën me rolin dhe funksionet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si një institucion i pavarur. AMF synon rregullimin e tregjeve nën mbikëqyrje, duke mbrojtur njëkohësisht interesat e konsumatorëve dhe investitorëve. Gjithashtu studentët u anketuan nga Autoriteti për matjen e njohurive financiare për tregjet nën mbikëqyrje.


# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-tetor 2018

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto për periudhën janar-tetor 2018 kapën vlerën mbi 13,747 milionë lekë, ose 5.13% më shumë se në periudhën janar-tetor 2017. Gjatë periudhës janar-tetor 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,068,456 me një rritje prej 5.02% krahasuar me periudhën janar-tetor 2017.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.10% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.58% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.32%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.77% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.23% të totalit të tregut.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-tetor 2018



Gjatë periudhës janar-shtator 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 955,620 me një rritje prej 5.34% krahasuar me periudhën janar-shtator 2017.

# ZHVILLIME TË TJERA

## Zhvillohet *workshopi* për prezantimin e projektligjit të ri “Mbi Titujt”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi në datën 12 nëntor një *workshop* me përfaqësues të shoqërive të tregut të kapitalit për të prezantuar projektligjin e ri “Mbi Titujt”.

Dokumenti i prezantuar nga konsulentët në kuadër të fazës së dytë të projektit “Forcimi i Kapaciteteve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek Zhvillimi i Tregut të Kapitaleve”, është hartuar në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian.



Gjatë zhvillimit të *workshopit*

---

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi në datën 12 nëntor një *workshop* me përfaqësues të shoqërive të tregut të kapitalit për të prezantuar projektligjin e ri “Mbi Titujt”.

---

Projektligji i ri “Mbi Titujt” e vë theksin tek një mbikëqyrje më e fortë e tregut të kapitaleve dhe synon në rritjen e transparencës dhe mbrojtjen e investitorit. *Workshopi* u përmbyll me pyetje dhe komente nga ana e përfaqësuesve të tregut. Diskutimi mbi projektligjin “Mbi Titujt” vijoi në datën 13 nëntor 2018 me përfaqësues të Shoqatës së Bankave.

## Zhvillohet Trajnimi “Për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Fondeve të Investimeve”

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) organizoi në datat 6-8 nëntor 2018, në Madrid, Spanjë, trajnimin “Për Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Fondeve të Investimeve”. Në këtë trajnim morën pjesë edhe përfaqësues nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Në seminar u theksua se, sot, në fokus të industrisë së fondeve të investime, mbetet:

Rastet praktike të studimit të përdorura gjatë seminarit të trajnimit inkurajuan frymën interaktive mes lektorëve dhe pjesëmarrësve.

- Risku sistemik;
- Likuiditeti dhe leva;
- Fondet e tregtueshme në Bursë (ETFs) dhe fondet që investojnë në indekse.

Gjatë 3 ditëve të trajnimit, lektorët, profesionistë dhe me eksperiencë në industrinë e fondeve, trajtuan me kompetencë të lartë çështjet në lidhje me:

- Tipet e ndryshme të fondeve të investimeve dhe administrimin e tyre;
- Shërbimet dhe ofruesit e shërbimeve në industrinë e fondeve;
- Mekanizmat për mbrojtjen e investitorëve me pakicë;
- Tendencat e zhvillimit të fondeve të investimit kudo në botë;
- Fondet e tregtueshme në Bursë (ETFs);
- Rregullimi i fondeve të investimit dhe shoqërive administruese;
- Mënyra e mbikëqyrjes së fondeve dhe shoqërive administruese (përgatitja për inspektim dhe analiza e të dhënave me qëllim mbikëqyrjen);
- Raste studimi mbi shkelje të bazës rregullative të fondeve, procesi investigues dhe marrja e masave.

Rastet praktike të studimit të përdorura gjatë seminarit të trajnimit inkurajuan frymën interaktive mes lektorëve dhe pjesëmarrësve. Gjatë ditëve të seminarit, pjesëmarrësit përfituan nga eksperiencia e rregullative dhe mbikëqyrëse e Autoritetit të Irlandës, të Mbretërisë së Bashkuar, të Hong Kongut, të Francës, të Katarit, të Luksemburgut.

Interes paraqitën çështjet në lidhje me metodat dhe mekanizmat në inspektimin e fondeve në mbështetje të prioritetëve dhe kategorizimit të riskut, si dhe disa raste studimi të shkeljeve dhe mënyrës investiguese të tyre, me qëllim marrjen e masave të duhura.

Industria e fondeve të investimeve në Evropë karakterizohet nga:

- Përputhshmëria me direktivat e BE-së. Viti 2018, filloi me zbatimin e Direktivës së MiFID II, ku vihet theksi tek produktet e përshtatshme për investitorin, standardizimi i produkteve derivative dhe ETFs, rregullat për likuiditet për fondet e investimit që investojnë në instrumentat e parasë;
- Zhvillimi i fondeve pasive si fondet që investojnë në indekse apo ETFs;

—○○○—  
Akademia e Drejtësisë Evropiane (Academy of European Law) zhvilloi në datat 15-16 nëntor, në Trier, Gjermani, konferencën për parandalimin e pastrimit të parave dhe shërbimet financiare në BE, AML.

- Qëndrueshmëria financiare. Në lidhje me këtë çështje BE është duke konsideruar riskun e qëndrueshmërisë si edhe risqet e tjera (risku i tregut, i likuiditetit) me qëllim vlerësimin dhe minimizimin e tij. Gjithashtu, në kuadër të qëndrueshmërisë financiare, po zhvillohen produktet e gjelbërta, apo produktet që ndikojnë në ambientin social. Shumë fonde kanë filluar të investojnë në *green product*;
- Në lidhje me fondet që mund të investojnë në krypto-asete, BE nuk ka nxjerrë rregulla apo metoda uniforme për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tyre. Ajo që është e rëndësishme, këto lloj fonde nuk lejohet të shiten për investitorët me pakicë.

### Zhvillohet konferenca “Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Shërbimet Financiare në BE”

Akademia e Drejtësisë Evropiane (Academy of European Law) zhvilloi në datat 15-16 nëntor, në Trier, Gjermani, konferencën për parandalimin e pastrimit të parave dhe shërbimet financiare në BE, AML.

Në këtë trajnim morën pjesë edhe përfaqësues nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës (KiE)”, për trajnimin e stafit për çështjet AML, si më poshtë: “Ndërsa produktet, teknologjia dhe shërbimet e reja po fillojnë të zhvillohen në sektorin financiar shqiptar, AMF duhet të vazhdojë të trajnohet për të siguruar zhvillimin e njohurive të nevojshme për instrumentet më komplekse dhe rreziqet përkatëse të lidhura me rrezikun e PPP/FT dhe kërkesat përkatëse”.

Tema të rëndësishme, të trajtuara në konferencë, ishin:

- **Abuzimi në sistemin bankar nga pastruesit e parave, bandat e organizuara kriminale dhe veprimi efektiv mbikëqyrës që ndërmerret.**

Kjo temë u trajtua gjerësisht, duke filluar me vështrimin e kuadrit ligjor aktual: Trendet e pajtueshmërisë globale të AML / CFT; rolin e Autoriteteve Evropiane të Mbikëqyrjes (ESA); sfidat e paraqitura të mbikëqyrësi nga Task Forca e Veprimit Financiar. Gjithashtu u diskutuan çështje praktike si: Pastrimi i Parave në Banka; Zgjedhja e qasjes korrekte, (*offsite* apo *onsite*) etj.

## ■ Zhvillime të reja ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe si ndikojnë ato në (prosperitetin) e sektorit bankar.

Gjatë shqyrtimit të temës u trajtua kuadri aktual i pagesave ndërkufitare; tregjet e letrave me vlerë; pastrimi i parave nëpërmjet letrave me vlerë; rritja e teknologjisë për të rritur suksesin bankar në luftën kundër PP/FT, etj.

## ■ Regjistrat e pronarëve përfitues, sipas Direktives 5 për AML, si dhe Implikimet e Direktivës 5 të AML për vendet e treta.

U trajtuan ndryshimet në kuadër të Direktivës 5 të AML që lidhen me regjistrin e pronarit përfitues, rritjen e aksesit të informacionit, transparencës, etj., si dhe klasifikimi i një vendi si vend "me rrezikshmëri të lartë"; Kontrollat për transaksionet; Masat e kujdesit ndaj klientit etj.

## ■ Lidhja midis AML dhe taksave.

U diskutuan pikat kyçe të Direktivës kundër shmangies së taksave dhe amendamenteve të saj; rregullat që lidhen me sistemet tatimore të vendeve të treta; përdorimi i AML për të parandaluar evazionin fiskal, etj.

## Konkluzione mbi informacionin e marrë gjatë konferencës

Ndryshimet kryesore në regjimin ekzistues ligjor për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit sipas Direktivës 5 për AML, paraqiten si më poshtë:

- Trajtohet gjerësisht procedura e pranimi si dhe regjistrimit të pronarit përfitues;
- Direktiva 5, të zbatohet pa shkelur legjislacionin kombëtarë, por ky konstatim i secilit vend, të shërbejë si fillim për ndryshimet ligjore në përputhje me Direktivën;
- Vendet e treta, që klasifikohen me rrezikshmëri të lartë duhen trajtuar në përputhje me Direktivën 5 për AML;
- Janë zgjeruar kompetencat e Njësive të Inteligjencës Financiare;
- Përdorimi i parave CASH, është "mbret" në pastrimin e parave, ndaj duhet patur kujdes dhe vigjilencë maksimale nga shtetet që të marrin masa për të minimizuar përdorimin e tyre;
- Evazioni fiskal ka lidhje dhe ndikim të madh me pastrimin e parave.

## Zhvillohet konferenca mbi sigurimin gjithëpërfshirës

Toronto Center në bashkëpunim me Bankën e Lituaniës, IAIS<sup>1</sup> dhe Aii<sup>2</sup>, zhvilluan në datat 12-16 nëntor në Vilnius, Lituani, konferencën me temë: “Sigurimi Gjithëpërfshirës”. Gjatë konferencës u diskutua mbi:

- Rëndësinë e promovimit të përfshirjes financiare në juridiksionin tonë;
- Rëndësinë e promovimit të sigurimit gjithëpërfshirës për gratë;
- Sa parime të shëndosha mbikëqyrëse mund të zbatohen në mënyrë që të inkurajohet zhvillimi i një tregu gjithëpërfshirës të sigurimeve;
- Rëndësinë e inovacionit për tregjet gjithëpërfshirëse të sigurimeve, si dhe;
- Si të nxitet përfshirja financiare duke inkurajuar mbikëqyrësit që të jenë të adaptueshëm në rolet e tyre për t’iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme zgjidhjeve inovative.

Temat e trajtuara në ditët e zhvillimit të këtij programi trajnimit kishin të bënin me:

- Aftësinë paguese mbi bazën e riskut dhe stabiliteti financiar, sipas perspektivës së IAIS;
- Përmbledhje të përfshirjes financiare në rajonin e Evropës Qendrore Lindore;
- Planin e veprimit, përcaktimi i problemit;
- Kuptimin e tregut dhe politikës së mjedisit;
- Rolin e Mbikëqyrësit të Sigurimeve;
- Planifikimin e veprimit - përcaktimi i një synimi SMART dhe hapat e veprimit;
- Rregullimin për inovacionin përgjegjës: qasjet dhe mjetet;
- Çështjet e kujdesit duke vënë theksin tek licencimi, operacionet, aftësia paguese dhe mbikëqyrja;
- Menaxhimin e palëve të interesuara dhe komunikimi, etj.;

Në përfundim të aktivitetit, pjesëmarrësit diskutuan rreth fushave kryesore që mund të përmirësohen në vendet përkatëse.

<sup>1</sup>International Association of Insurance Supervisors

<sup>2</sup>Access to Insurance Initiative

---

Toronto Center në bashkëpunim me Bankën e Lituaniës, IAIS<sup>1</sup> dhe Aii<sup>2</sup>, zhvilluan në datat 12-16 nëntor në Vilnius, Lituani, konferencën me temë: “Sigurimi Gjithëpërfshirës”.

---



## Seminar mbi “Modelet parashikuese për jetën dhe shëndetin”

Akademia Aktuariale Evropiane në bashkëpunim me Kolegjin e Aktuarëve të Katalonjës zhvilluan në datat 15–16 nëntor, në Barcelonë, Spanjë, seminarin me titull “Modelet parashikuese për jetën dhe shëndetin” me pjesëmarrjen e aktuarëve dhe ekspertëve të tregut të sigurimeve nga 20 vende të ndryshme të Botës.



*Gjatë zhvillimit të seminarit*

Temat kryesore që u trajtuan kishin të bënin me krijimin e modeleve parashikuese të cilët mund të përdoren në shumë aktivitete të sigurimit të jetës dhe shëndetit.

Temat kryesore që u trajtuan kishin të bënin me krijimin e modeleve parashikuese të cilët mund të përdoren në shumë aktivitete të sigurimit të jetës dhe shëndetit. Si fillim, me anë të gjuhës së programimit R duke përdorur regresionin linear, u analizua impakti i normës së interesit dhe inflacionit në përcaktimin e primit të sigurimit. Në vijim me anë të regresionit të shumëfishtë linear, regresionit logjistik, atij të përgjithësuar dhe analizës të komponenteve kryesore, u analizuan faktorët e riskut kryesorë, të cilët mund të përdoren gjatë procesit të marrjes në sigurim dhe vlerësimit të provigjoneve teknike.

Në përfundim, bazuar në të dhënat e tregut të sigurimeve, u trajtuan katër shembuj praktik në lidhje me modelet parashikuese, të cilët trajtonin të gjitha hapat që ndiqen në zbatimin e këtyre modeleve. Duke filluar nga mbledhja e të dhënave, përpunimi i tyre, krijimi i modelit, vlerësimi dhe zhvillimi i tij.

## Zhvillohen mbledhjet e Komiteteve të IAIS, Mbledhja e Përgjithshme Vjetore, si edhe Konferenca e 25-të Vjetore

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) zhvilloi në datat 8-9 nëntor, në Luksenburg, Konferencën e 25-të Vjetore, e cila u parapri nga Mbledhja e Përgjithshme Vjetore e Anëtarëve dhe nga mbledhjet e Komitetit.

Jonathan Dixon, Sekretar i Përgjithshëm i IAIS e vlerësoi këtë si një javë me arritje të jashtëzakonshme në avancimin e iniciativave aktuale të IAIS dhe duke marrë miratimin nga anëtarët e saj për prioritetet strategjike të ardhshme për 2020-2024. Sekretari i Përgjithshëm theksoi se fokusi më i madh po vihet në tendencat e reja të zhvillimit që ndikojnë si te tregjet e zhvilluara edhe tek ato në zhvillim, duke përfshirë FinTech, rreziqet kibernetike, rrezikun e klimës dhe sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) zhvilloi në datat 8-9 nëntor, në Luksenburg, Konferencën e 25-të Vjetore, e cila u parapri nga Mbledhja e Përgjithshme Vjetore e Anëtarëve dhe nga mbledhjet e Komitetit.



*Gjatë zhvillimit të konferencës*

Tema e Konferencës ishte "Reimagjini i Sigurimeve" ("Reimagining Insurance") dhe panelistët gjatë kësaj konference shqyrtuan rolin e mbikëqyrësve në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, duke iu përgjigjur progresit të teknologjisë lidhur me Big Data dhe inteligjencën artificiale, si edhe duke realizuar lidhjet e nevojshme midis mbikëqyrjes së kujdesshme dhe sjelljes së biznesit.

Në takimet para konferencës vjetore, IAIS bëri një hap të madh përpara në lidhje me një tjetër element kyç të axhendës së reformës pas krizës financiare, pikërisht zhvillimin e kuadrit holistik për vlerësimin dhe zbutjen e rrezikut sistemik në sektorin e sigurimeve.

Komiteti gjithashtu miratoi dokumente të rëndësishme mbikëqyrëse për rritjen e digjitalizimit në tregun e sigurimit dhe ndikimi i tij i mundshëm mbi konsumatorin, mbikëqyrjen e sigurisë kibernetike të vetë siguruesve, si edhe përbërjen dhe rolin e Bordit.

Mbledhja e Përgjithshme Vjetore miratoi rishikimet e Parimeve Themelore të Sigurimit (ICP) të IAIS lidhur me ndryshimi i kontrollit dhe transferimin e portofolit (ICP 6). Ajo gjithashtu miratoi propozimet e bëra për disa ICP të rishikuara që lidhen me menaxhimin e rrezikut dhe kontrollet e brendshme (ICP 8), investimet (ICP 15), menaxhimin e riskut të ndërmarrjes për qëllimet e aftësisë paguese (ICP 16), dhe publiket e hapura (ICP 20).

Këto ndryshime do të publikohen për qëllime informimi përpara miratimit, në fund të vitit 2019. Në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore, Anëtarët e IAIS miratuan ndryshime të rëndësishme të qeverisjes së vetë organizatës, siç ishte rritja e anëtarëve me të drejtë vote në Komitetet Ekzekutive, për të përfshirë mbikëqyrës nga tregjet kryesore globale të sigurimeve dhe për të siguruar diversitetin e përfaqësimit rajonal si nga tregjet e zhvilluara dhe ato në zhvillim.

AMF është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) që prej vitit 2001. Ky anëtarësim ka ndihmuar në thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar mes autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve.

### **Zhvillohet takimi i 16-të i Iniciativës së Mbikëqyrjes së Sigurimeve për Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore**

Iniciativa e Mbikëqyrjes së Sigurimeve për Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore(CESEE) zhvilloi në datë 30 nëntor, në Vjenë, Austri takimin e 16-të të saj. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga vende të ndryshme të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Gjatë takimit u prezantuan temat, të cilat kishin të bënin me:

- Vlerësimin e kërkesave të kapitalit nën regjimin e Solvency II dhe sfidat e hasura nga pikëpamja e mbikëqyrjes;
- Mbikëqyrjen e rregullave të sjelljes, kryesisht në aspektin e kanaleve të shpërndarjes apo ndërmjetësve;
- Përvoja me ushtrimin e marrjes në administrim si një masë mbikëqyrjeje;
- Nivelin e zhvillimit të tregjeve të sigurimeve të Ballkanit Perëndimor dhe një krahasueshmëri me disa nga vendet përfaqësuese të Bashkimit Evropian, temë e cila u prezantua nga përfaqësuesi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë.

○ ○ ○

Iniciativa e Mbikëqyrjes së Sigurimeve për Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore(CESEE) zhvilloi në datë 30 nëntor, në Vjenë, Austri takimin e 16-të të saj.

○ ○ ○

Studimi i kryer nga AMF, pati si qëllim pasqyrimin e gjendjes së tregjeve të sigurimeve në Ballkanin Perëndimor ku përfshihet edhe Shqipëria, bazuar në disa tregues kyç, duke nxjerrë në pah ngjashmëritë dhe duke bërë më pas lidhjen me faktorë të tjerë për të vlerësuar dhe identifikuar ata që mund të jenë më tepër shkaktarë për këtë realitet, duke u bazuar mbi një analizë statistikore.

Në këtë drejtim, studimi bazohej edhe në krahasueshmërinë me vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian, me qëllim vënien në kontrast të treguesve dhe faktorëve që diferencojnë dukshëm nivelin e zhvillimit të tregjeve të sigurimeve të Ballkanit Perëndimor dhe atyre të vendeve të zhvilluara, anëtare të Bashkimit Evropian. Prezantimi konkludoi me evidentimet e faktorëve që japin ndikimin kryesor në nivelin e zhvillimit të tregjeve të sigurimeve, disa sugjerime, si dhe ilustrime të nismave të Autoritetit në aspektin e rritjes së ndërgjegjësimit të konsumatorëve dhe rritjen e bashkëpunimit me institucione të tjera në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Qëllimi i takimit të 16-të të Iniciativës së Mbikëqyrjes së Sigurimeve për Evropën Qendrore, Lindore dhe Jug-Lindore ishte jo vetëm prezantimi i temave të ndryshme në lidhje me vendet pjesëmarrëse, por edhe nxitjen e bashkëbisedimit dhe ndarjes së eksperiencave të ndryshme ndërmjet përfaqësuesve të pranishëm.

### Zhvillohet takimi mbi sfidat aktuale të mbikëqyrjes me fokus rrezikun



Iniciativa e trajnimit për mbikëqyrjen financiare në bashkëpunim me Autoritetin Polak të Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi takimin mbi sfidat aktuale të mbikëqyrjes me fokus rrezikun në datat 21-23 nëntor 2018, në Varshavë, Poloni.

Iniciativa e Trajnimit për Mbikëqyrjen Financiare (Training Initiative for Financial Supervision, TIFS) është një qendër trajnimesh për mbikëqyrësit e të gjithë sektorëve të tregut financiar të Evropës (banka, tregu i kapitaleve, pensione dhe sigurimeve). Kjo qendër ka për qëllim të krijojë një forum të gjerë diskutimesh midis mbikëqyrësve evropianë, ku ndahen eksperiencat dhe zhvillohen njohuritë praktike nëpërmjet programeve për stafin e specializuar të autoriteteve mbikëqyrëse.

Trajnimi ishte një ndërthurje mes prezantimeve teorike dhe situatave konkrete, si edhe rasteve studimore. Programi i trajnimit përfshinte disa fusha të mbikëqyrjes të sigurimeve, si të Jetës edhe të Jo-Jetës. Në mënyrë të detajuar temat e trajtuara ishin si më poshtë:

---

Trajnimi ishte një ndërthurje mes prezantimeve teorike dhe situatave konkrete, si edhe rasteve studimore.

---

- Matrica e riskut – veçanërisht risku i drejtimit dhe i sistemit të qeverisjes;
- Raportimi me bazë rrezikun – përmbajtja dhe cilësia e raportimit veçanërisht për qeverisjen e shoqërisë dhe riskun e drejtimit;
- Sistemi i qeverisjes së shoqërisë – aspekte praktike;
- ORSA, si një element i mbikëqyrjes me bazë riskun – eksperiencia e dy viteve të fundit;
- Kërkesat për përshtatshmëri e përputhshmëri – aspekte praktike të mbikëqyrjes me bazë rrezikun;
- Përshtatshmëria e produkteve të sigurimit;
- Mbikëqyrja e vazhdueshme e drejtuesve dhe aksionerëve influencues;
- Eksperiencia e aktivitetit të tregut në Direktivën e Shpërndarjes së Sigurimeve (IDD) dhe rregulloren mbi investimet e paketave të sigurimit dhe investimet në produktet e sigurimeve. Zbatimi i (PRIIPs) dhe përgatitja për IDD në fokusin e industrisë.

Gjatë trajnimit u shkëmbyen eksperiencia, të cilat do të ndihmojnë në zbatimin e hapave të reja progresive për ecurinë dhe stabilitetin e tregut të sigurimeve në Shqipëri. Gjithashtu edhe trajtimi i rasteve aktuale të Shqipërisë, ndikon në zhvillimet dhe përpjekjet aktuale të Autoritetit për mbajtjen e një tregu të qëndrueshëm e stabilitet financiar.

## Produkti i Pensionit Personal Pan-Evropian - Një hap drejt pensioneve të qëndrueshme

Z. Gabriel Bernardino, Kryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) në fjalën e tij përshëndetëse në Konferencën Ndërkombëtare "Produkti i Pensionit Individual Pan-Evropian - Rregullorja, Efektet dhe Problemet" fletë për tre tematika kryesore:

(i) Përse na nevojitet një Produkt Pensioni Individual Pan-Evropian (PEPP)?

(ii) Cilat janë përfitimet nga PEPP-së?

(iii) Cili është roli i EIOPA-s në të ardhmen e PEPP-së?

Konferenca u organizua nga Universiteti i Financave, Biznesit dhe Sipërmarrësit (VUZF) në kuadër të Presidencës Bullgare të Këshillit të Bashkimit Evropian, 20 maj 2018.

(Pjesa e dytë dhe e fundit, me shkurtime dhe redaktime)

Hartimi i Produktit të Pensionit Individual Pan-Evropian (PEPP) duhet të sigurojë standardet më të larta në transparencë, drejtësi, qeverisje dhe administrim të riskut.

### Cili do jetë roli i EIOPA-s në të ardhmen?

- Autorizimi
- Transparenca
- Mbikëqyrja

Për shkak të natyrës së saj evropiane dhe kërkesave konceptuale të qenësishme për standardizimin dhe lëvizshmërinë, EIOPA, si një autoritet mbikëqyrës evropian, mund të sigurojë standarde të larta konsistente për PEPP-të e autorizuara në të gjithë Evropën.

Unë e mirëpres propozimin e Komisionit Evropian që EIOPA të luaj një rol kyç në zbatimin e qëndrueshëm të kërkesave konsistente për autorizim të Bashkimit Evropian, për të mbrojtur përdorimin e duhur të emrit PEPP-së dhe për të siguruar PEPP-ve cilësisë së lartë në të gjithë Evropën.

Për më tepër, mandati i EIOPA-s për të nxitur mbikëqyrje konvergjente ka rëndësi të madhe për besimin dhe sigurinë e PEPP. Në këndvështrimin tim, nevojitet një koordinim më i mirë përmes zhvillimit të planeve mbikëqyrëse për PEPP, duke mbështetur iniciativën e një produkti të vërtetë pan-evropian.

Për të forcuar transparencën e mbikëqyrjes së PEPP-ve për konsumatorët e BE-së, unë propozoj që EIOPA-s duhet të ketë mandat për publikimin e një raport vjetor mbi aktivitetet e mbikëqyrjes së PEPP-së të kryera në të gjithë Evropën.

Hartimi i Produktit të Pensionit Individual Pan-Evropian (PEPP) duhet të sigurojë standardet më të larta në transparencë, drejtësi, qeverisje dhe administrim të riskut.

---

Le të jemi të sigurtë, në Evropë, por edhe në shumë vende të tjera të zhvilluara dhe në zhvillim, hendeku i financimit të pensioneve është në rritje dhe do të bëhet akoma më i vështirë, ose edhe e pamundur për ta mbyllur atë. "Bomba me sahat" e pensioneve ka qenë në axhendën tonë së paku që prej 30 vitesh.

---

Për EIOPA, informacionet e standardizuara, të krahasueshme dhe të lidhura me PEPP-të duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme për konsumatorët, për t'i ndihmuar ata të marrin vendime të mirë-informuara dhe të vetëdijshme për skemat e kursimeve të tyre për pension.

Në të njëjtën kohë, informacioni për PEPP duhet të jetë i përshtatshëm. Prandaj, publikimet për PEPP të dedikuara konsumatorëve duhet të jenë lehtësisht të kuptueshme dhe të zhvillohen më tej, duke dhënë edhe deklaratat e përfitimeve të rregullta për ta.

Për më tepër, regjimi i tatimeve ndaj PEPP duhet të jetë tërheqës. Duke hartuar PEPP-në me karakteristika të përshtatshme, duhet mundësohet të paktën që PEPP të kenë të njëjtin trajtim tatimor sikurse edhe produktet kombëtare të pensioneve.

PEPP ka potencial të lartë për t'u kthyer në një produkt afatgjatë i kursimit të pensionit të vërtetë evropian, të sigurt, transparent dhe me kosto-efikase, i cili do t'u ofrojë pensionistëve një strukturë krejtësisht të re të pensioneve individuale për të kursyer për pensionin e ardhshëm. Potenciali është i madh, por ne duhet të vështrijmë shtyllën e tretë të pensioneve dhe kursimeve për pensionet: Zgjerimi/shkalla, konkurrenca dhe transparenca janë kyçi i këtij procesi.

Le të jemi të sigurtë, në Evropë, por edhe në shumë vende të tjera të zhvilluara dhe në zhvillim, hendeku i financimit të pensioneve është në rritje dhe do të bëhet akoma më i vështirë, ose edhe e pamundur për ta mbyllur atë. "Bomba me sahat" e pensioneve ka qenë në axhendën tonë së paku që prej 30 vitesh. Sidoqoftë, pamja e përgjithshme për qëndrueshmërinë e premtimeve për pensionet, qofshin këto nga shteti, pensionet profesionale apo kursimet private, nuk është aspak komode.

Sektori i pensioneve evropiane është nën presion për të adresuar sa më parë sfidat e tij dhe për të promovuar premtime të qëndrueshme për pensionet. Ne kemi nevojë për më shumë vendime politike me ide afatgjata dhe këto vendime duhet të jenë të guximshme dhe duhet të merren tani.

PEPP-ja nuk është një plumb argjendi dhe as përgjigja e vetme për këtë "bombë me sahat". Por mund të jetë një mjet i rëndësishëm për të ndihmuar në mbylljen e hendekut të pensioneve. PEPP mund t'u tregojë qytetarëve të Bashkimit Evropian se Evropa i ndihmon ata në krijimin e një pensioni më të fortë dhe më të qëndrueshëm. PEPP do të ndihmojë qytetarët e Bashkimit Evropian që të jenë më afër projektit evropian. Për të mirën tonë dhe të brezave të ardhshëm, dhe për hir të vetë Evropës, ne nuk mund të dështojmë.

# **FJALOR TERMASH**

## **DOW JONES INDUSTRIAL AVERAGE (DJIA)**

Ky është treguesi më i popullarizuar dhe më i përdorur gjerësisht në tregun e aksioneve të SHBA. Ai përbëhet nga një listë e çmimeve të 30 kompanive më të tregtueshme Blue Cip. Ky tregues shihet nga investitorët si një tregues i shëndetit dhe drejtimit që po merr tregu i aksioneve.

## **EARNINGS / PROFIT**

Ajo pjesë e të ardhurave që mbetet pasi hiqen të gjitha kostot, shpenzimet dhe taksat gjatë një periudhe raportimi. Quhet ndryshe edhe vija fundore. Kur një kompani fiton para thuhet se është “me të zeza”. Kur humbet para, është “me të kuqe”.

## **INCOME / REVENUE / SALES**

Ajo çfarë arkëton kompania për mallrat që prodhon apo për shërbimet që ofron. Nuk është e njëjta gjë si “fitimi”.

## **MARKET CAPITALIZATION**

Njihet ndryshe edhe si “market cap”. Llogaritet duke shumëzuar çmimin aktual për kuotë me numrin e kuotave.

## **MUTUAL FUND**

Një Fond Investimesh që kombinon paratë nga një grup i madh investitorësh për të blerë aksione apo investime të tjera.

## **SPREAD**

Diferenca mes çmimit më të ulët që një shitës është i gatshëm të pranojë kur shet një aksion dhe çmimit më të lartë që një blerës është i gatshëm të pranojë kur blen një aksion.

## **STOCK / EQUITIES**

Nëse ti zotëron aksione, zotëron një pjesë të kompanisë. Çdo aksion evidentohet përmes një çertifikate të shkruar.

## **VOLUME**

Numri i kuotave të aksione që tregtohen në një ditë.

## **YIELD**

Yield i referohet fitimeve të realizuara në një investim për një periudhe të caktuar kohe dhe shprehet në përqindje bazuar në shumën e investuar ose në vlerën aktuale të tregut ose në vlerën nominale të letrës me vlerë. Ai përfshin interesin e fituar ose dividendët e marra nga zotërimi i një letre me vlerë të caktuar. Në varësi të natyrës dhe vlerësimit (fikse/luhatëse) të letrës me vlerë, yield-et mund të klasifikohen si të njohura ose të parashikuara. Yield zakonisht llogaritet mbi baza vjetore.



## **Greqi**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Siguruesit në Greqi raportuan prime të shkruara bruto prej 2.87 miliardë euro në fund të shtatorit 2018, me një rritje prej 2.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sigurimi i Jetës pësoi rënie me 0.4%, duke arritur në 1.36 miliardë euro prime të shkruara bruto. Ndërsa sigurimi i Jo-Jetës arriti në 1.5 miliardë euro prime të shkruara bruto, duke u rritur me 4.4%.

## **Kosovë**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sigurimet e Jo-Jetës në tregun e sigurimeve në Kosovë, deri në shtator 2018, u rritën me 6%, duke arritur në 70.3 milionë euro prime të shkruara bruto. Sigurimi i Jetës arriti në 2.2 milionë euro prime të shkruara bruto, me një rritje prej 16%. 15 sigurues operojnë në treg, nga të cilët 12 për sigurimin e Jo-Jetës dhe 3 për sigurimin e Jetës.

## **Kroaci**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Kroaci shënoi 1.02 miliardë euro prime të shkruara bruto deri në shtator 2018, me një rritje prej 10.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Dëmet e paguara u rritën me 13%, për të arritur në 539.7 milionë euro. Sigurimi i Jetës rregjistroi një rritje prej 11.6%, ku primet e shkruara brutom arritën vlerën 322.3 milionë euro. Ndërsa primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 699.7 milionë euro, me një rritje prej 10.45%.

## Mali i Zi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Gjatë 9-mujorit të 2018, tregu i sigurimeve në Malin e Zi raportoi 65 milionë euro prime të shkruara bruto, me 6% rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Krahasuar me shtator 2017, sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 5.98%, ndërsa sigurimet e Jetës me 5.96%. Përsa i përket sigurimit të Jo-Jetës, rritja më e madhe ishte në sigurimet KASKO (me 15%), ndërsa sigurimi i pronës pësoi rënie me 3.4%.

Siguruesit paguan 31 milionë euro dëme, ose 25% më shumë sesa e njëjta periudhë e vitit të kaluar, pjesa më e madhe në sigurimin motorik.

## Sloveni

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Siguruesit slovenë raportuan një volum primesh të shkruara bruto prej 1.78 miliardë euro për 9-mujorin e vitit 2018, me një rritje prej 6.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Dëmet e paguara u rritën me 4.8%, duke arritur në 1.15 miliardë euro. Rritja më e madhe u shënua në sigurimin e Jetës, por megjithatë edhe në fund të shtatorit kjo kategori zinte 30% të primeve të shkruara bruto. Përsa i përket sigurimit të Jo-Jetës, sigurimi motorik shënoi rritjen më të madhe.

## Turqi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Turqi e mbylli 9-mujorin e vitit 2018 me një volum primesh të shkruara bruto prej 39.5 miliardë TRY (lira turke, monedha vendase), me rritje 18.16%. Por, zhvlerësimi shumë i madh i lirës ndaj euros ka prekur rezultatet e tregut në monedhën europiane, ku rezultojnë një rënie dyshifrore. Primet e shkruara bruto në euro llogariten në 5.67 miliardë, me një rënie 28.73%. Sigurimi i Jetës pësoi rënie gjatë 9-mujorit 2018. Në sigurimin e Jo-Jetës, sigurimi motorik shënoi rritjen më të madhe, kryesisht për shkak të MTPL-së.



---

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)